

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fatime Dërrmaku, me zyrtarin ligjor Edona Grajçevci, në çështjen penale, kundër të pandehurit **N. H.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4748/15, të dt.03.05.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.23.10.2017, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 4748/15, të dt.03.05.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: N. H., nga i ati S. , i lindur me data e lindjes... , me vendbanim ne M. rruga “Xh. M. “pa nr. me numër personal *numri personal.....*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTORË

S e p s e: Me dt.06.08.2015, rreth orës 15:00h, ne rrugën “... “ ne P. duke e drejtuar automjetin e tipit “F. M. “ngjyre te hiri me targa te regjistrimit *numri i targave...* nga pa kujdesia duke menduar me mendje lehtësi se deri te aksidenti nuk do te vije ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë ne atë mënyrë qe e ka shkelur nenin 42.1 te LSKRR-se duke marr veprimin e kthimit gjysme rrethore ne mënyrë te pa sigurt dhe për pasoj kur kalon ne pjesën e përparme ne shiritin e majtë e godet motoçikletën e tipit “ Honda “ me targa te regjistrimit *numri i targave...* te cilën e ngiste tani i dëmtuari B. R. i cili ka pësuar lëndime te leta trupore ,-

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B. R. me vendbanim ne P. rruga “...” nr... , për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr. 4748/15, të dt.03.05.2016, e ka akuzuar **N. H.**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal nr. 2014-AR-1878, i datës 11.08.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë ing. F. B. të datës 31.08.2015 ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit Dr. N. H. e dt.14.02.2015, dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri **N. H.**, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.2139/16, i dt.23.10.2017

Zyrtarja Ligjore
Edona Grajçevci

Gjyqtarja,
Fatime Dërrmaku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të tij, në këtë gjykatë.